



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR ISHËM

VENDIM

Nr. 8, datë 10.02.2026

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR
PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT “SELMANI IMPORT-
EXPORT” SH.P.K, ME VENDNDODHJE: ISH KOMBINATI “MISTO
MAME”, BASHKIA TIRANË.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime industriale, të subjektit “Selmani Import-Export” sh.p.k., me vendndodhje: Ish Kombinati “Misto Mame”, Bashkia Tiranë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujqor (pus-shpimi):

- X= 481718.484
- Y= 4575780.427
- Z= 105 m

- Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 0.5 \text{ l/sek}$
- Qëllimi i përdorimit: Për qëllime industriale.
- Thellësia e pus-shpimit: 14 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : 13 m
- Koordinatat e pikës së shkarkimit (**Vaska e Dekantimit**):

$X = 481680.264;$

$Y = 4575785.607;$

$Z = 104 \text{ m}$

- Prurja që shkarkohet: $Q = 0.5 \text{ l/sek}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBL ISHËM

ADRIAN GURRA

